



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.04.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen: Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimeve nr. 178, 178, 180 e 181, datë 18.04.2019 dhe 185, 186 e 187, datë 23.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, të Shqipërisë në qarqet Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë” dhe “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë” si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve znj. Fatjona Dhimitri, z. Andi Përmeti, z. Erion Picari, z. Artir Roshi, z. Zef Shtjefni, z. Nikolin Staka dhe z. Eugen Bojaxhiu.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Ermonela Felaj dhe Muslim Murizi

Mungojnë:

Ulsi Manja dhe Damian Gjikhuri

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet për dhënien e mandatit të deputetëve të kandidatëve të listës shumëemërore të Partisë Demokratike në qarqet Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë. Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun Berat

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve. Kandidatëve që kanë fituar mandatin e deputetit janë konkretisht:

- Znj. Fatjona Dhimitri shpallur deputete i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 178, datë 18.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Gjirokastrë.

- Z. Andi Përmeti shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 179, datë 18.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Korçë.

- Z. Eugen Bojaxhiu, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 180, datë 18.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Lëvizja Socialiste për integrim, Qarku Berat.

- Z. Erion Piciri, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 181, datë 18.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Tiranë.

- Z. Artur Roshi, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 185, datë 23.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Tiranë.

- Z. Zef Shtjefni, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 186, datë 23.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Shkodër.

- Z. Nikolin Staka, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 187, datë 23.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Shkodër.

Siç jeni në dijeni, si rezultat i dorëheqjeve të deputetëve të opozitës, nga mandati i deputetit. Kuvendi, në mbështetje të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ta njoftuar për vakancat e krijuara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet e mësipërme, nr. 178, 179, 180, 181, 185, 186 dhe 187 i ka dhënë mandatin e deputetit kandidatëve vijues të listave respektive. Vendimet i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetëve të ri?

Nuk ka.

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Të bëhet gati edhe raporti. T'u shpërndahet deputetëve nesër në seancë!

Znj. Klotilda Bushka ta paraqesë në seancë raportin, siç është rregulli, i cili shpreh këtë qëndrim të Këshillit, i cili do të votohet nga seanca.

Të njoftohen të 7 kandidatët që nesër në orën 10:00 të jenë në seancë plenare. Mirupafshim! Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET